



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

Lënda: **Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË**  
(për publikim në SPE dhe buletin e njoftimeve publike)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT  
( NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT )  
BASHKIA MALLAKASTËR**

Drejtuar: **“RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” ShA**, me numër NIPT J62904264O, me adresë qendrore sipas QKB: Elbasan Bradashesh BALEZ POSHTE Fshati Balez Poshte, zona kadastrale nr.1079, nr.pasurise 322/11, 1 km nga kryqezimi i fshatit Kusarth (ne kryqezimin e rruges se fabrikes se çimentos rrugen e fshatit Balez Siper)

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **“E hapur”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-07218-05-30-2024**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndërtim i shkollës “Gjokë Doçi”**, me fond limit **159,811,598** (njëqind e pesëdhjetë e nëntëmilion e tetëqind e njëmbëdhjetë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) **Lekë pa TVSH**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.47, datë 12 Gusht 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

**Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:**

1. **Operatori Ekonomik (OE) “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sha**, me NIPT J62904264O, me ofertë ekonomike në shumën prej **105,635,461.40** (njëqind e pesëmilion e gjashtëqind e tridhjetë e pesëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një pikë dyzetë) **lekë pa TVSH.**
2. **Operatori Ekonomik (OE) “NDERTIMI” shpk**, me NIPT **K11325002C**, me ofertë ekonomike në shumën prej **108,855,114.26** (njëqind e tetëmilion e tetëqind e pesëdhjetë e pesëmijë e njëqind e katërbëdhjetë pikë njëzetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**
3. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “GLAVENICA” shpk**, me NIPT K17710805A & **“KTHELLA” shpk**, me NIPT J69303023D, me ofertë ekonomike në shumën prej **109,303,282** (njëqind e nëntëmilion e treqind e tremijë e dyqind e tetëdhjetë e dy) **lekë pa TVSH.**
4. **Operatori Ekonomik (OE) “L.T.E CONSTRUCTION” shpk**, me NIPT L78006801F, me ofertë ekonomike në shumën prej **109,747,157.41** (njëqind e nëntëmilion e shtatëqind e dyzetë e shtatëmijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë dyzetë e një) **lekë pa TVSH.**
5. **Operatori Ekonomik (OE) “S I R E T A 2F” shpk**, me NIPT K51501008J, me ofertë ekonomike në shumën prej (oferta pas korrigjimit dhe pranimit nga ofertuesi) **111,050,856.21** (njëqind e njëmbëdhjetëmilion e pesëdhjetëmijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë njëzetë e një) **lekë pa TVSH.**
6. **Operatori Ekonomik (OE) “KEVIN KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT K71401004W, me ofertë ekonomike në shumën prej **111,158,504.46** (njëqind e njëmbëdhjetëmilion e njëqind e pesëdhjetë e tetëmijë e pesëqind e katër pikë dyzetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**
7. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “B93 II” shpk**, me NIPT L52209050O & **“B93” shpk**, me NIPT J62903508R, me ofertë ekonomike në shumën prej **111,403,301.53** (njëqind e njëmbëdhjetëmilion e katërqind e tremijë e treqind e një pikë pesëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH.**
8. **Operatori Ekonomik (OE) “INA” shpk**, me NIPT J61814009W, me ofertë ekonomike në shumën prej **112,613,275.32** (njëqind e dymbëdhjetëmilion e gjashtëqind e trembëdhjetëmijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë pikë tridhjetë e dy) **lekë pa TVSH.**
9. **Operatori Ekonomik (OE) “SHENDELLI” shpk**, me NIPT K07924803N, me ofertë ekonomike në shumën prej **114,830,694** (njëqind e katërbëdhjetëmilion e tetëqind e tridhjetëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**
10. **Operatori Ekonomik (OE) “ED KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT K61625001I, me ofertë ekonomike në shumën prej **116,641,432.66** (njëqind e gjashtëmbëdhjetëmilion e gjashtëqind e dyzetë e njëmijë e katërqind e tridhjetë e dy pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**
11. **Operatori Ekonomik (OE) “AIDA KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT M03116403L, me ofertë ekonomike në shumën prej **119,486,280.40** (njëqind e nëntëmbëdhjetëmilion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e tetëdhjetë pikë dyzetë) **lekë pa TVSH.**

- 12. Operatori Ekonomik (OE) “PEPA GROUP” shpk**, me NIPT L42215009L, me ofertë ekonomike në shumën prej **120,188,262.54** (njëqind e njëzetëmilion e njëqind e tetëdhjetë e tetëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**
- 13. Operatori Ekonomik (OE) “BEAN” shpk**, me NIPT J72510445Q, me ofertë ekonomike në shumën prej **121,397,938** (njëqind e njëzetë e njëmilion e treqind e nëntëdhjetë e shtatëmijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) **lekë pa TVSH.**
- 14. Operatori Ekonomik (OE) “INERTI” shpk**, me NIPT J66926804L, me ofertë ekonomike në shumën prej **122,149,137.56** (njëqind e njëzetë e dymilion e njëqind e dyzetë e nëntëmijë e njëqind e tridhjetë e shtatë pikë pesëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**
- 15. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “COGREN” shpk**, me NIPT J74818825K & **“JOGI” shpk**, me NIPT J63229478K & **“A.E.K & CO” shpk**, me NIPT K64331804P, me ofertë ekonomike në shumën prej **122,222,222** (njëqind e njëzetë e dymilion e dyqind e njëzetë e dymijë e dyqind e njëzetë e dy) **lekë pa TVSH.**
- 16. Operatori Ekonomik (OE) “AURORA KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT K02017003I, me ofertë ekonomike në shumën prej **124,031,044** (njëqind e njëzetë e katërmilion e tridhjetë e njëmijë e dyzetë e katër) **lekë pa TVSH.**
- 17. Operatori Ekonomik (OE) “SALILLARI” shpk**, me NIPT J62903125G, me ofertë ekonomike në shumën prej **133,004,890.22** (njëqind e tridhjetë e tremilion e katërimjë e tetëqind e nëntëdhjetë pikë njëzetë e dy) **lekë pa TVSH.**
- 18. Operatori Ekonomik (OE) “DAJTI PARK 2007” shpk**, me NIPT K11507003S, me ofertë ekonomike në shumën prej **139,022,318.42** (njëqind e tridhjetë e nëntëmilion e njëzetë e dymijë e treqind e tetëmbëdhjetë pikë dyzetë e dy) **lekë pa TVSH.**
- 19. Operatori Ekonomik (OE) “LIS KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT K66613407H, me ofertë ekonomike në shumën prej **139,451,285.81** (njëqind e tridhjetë e nëntëmilion e katërqind e pesëdhjetë e njëmijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e një) **lekë pa TVSH.**
- 20. Operatori Ekonomik (OE) “LIQENI VII” shpk**, me NIPT K01730502W, me ofertë ekonomike në shumën prej **143,513,870** (njëqind e dyzetë e tremilion e pesëqind e trembëdhjetëmijë e tetëqind e shtatëdhjetë) **lekë pa TVSH.**
- 21. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk**, me NIPT K82230002K & **“STERKAJ” shpk**, me NIPT J68310708M, me ofertë ekonomike në shumën prej **144,259,631** (njëqind e dyzetë e katërmilion e dyqind e pesëdhjetë e nëntëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e një) **lekë pa TVSH.**
- 22. Operatori Ekonomik (OE) “DESARET COMPANY” shpk**, me NIPT K01816001J, me ofertë ekonomike në shumën prej **149,770,495.07** (njëqind e dyzetë e nëntëmilion e shtatëqind e shtatëdhjetëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë pikë zero shtatë) **lekë pa TVSH.**

- 23. Operatori Ekonomik (OE) “EB-2000” shpk**, me NIPT L87708801M, me ofertë ekonomike në shumën prej **159,100,000** (njëqind e pesëdhjetë e nëntëmilion e njëqindmijë) **lekë pa TVSH**.
- 24. Operatori Ekonomik (OE) “SENKA” shpk**, me NIPT J94808405Q, me ofertë ekonomike në shumën prej (ofertë e korigjuar dhe mbi fondin limit) **160,326,597.43** (njëqind e gjashtëdhjetëmilion e treqind e njëzetë e gjashtëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë dyzetë e tre) **lekë pa TVSH**.

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm, përkatësisht për arsyet:**

**1. Operatori Ekonomik (OE) “L.T.E CONSTRUCTION” shpk**, me NIPT L78006801F, me ofertë ekonomike në shumën prej **109,747,157.41** (njëqind e nëntëmilion e shtatëqind e dyzetë e shtatëmijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë dyzetë e një) **lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, sa i takon kontratave të ngjashme, në kuptim të nenit 77 të LPP dhe pikës 5, të nenit 39, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se dokumentacioni shoqëruar i kontratës me objekt: “Godinë banimi dhe shërbimi 1, 2, 5, 8 dhe 11 kate me 2 kat parkim nëntoke në pronë të shoqërsisë Lloxhall shpk” paraqitet me pasaktësi, pasi nuk përputhet vlera e përcaktuar në formularin e vlerësimit dhe vlera referuese në akt kolaudimin e objektit. Për më tepër, akt kolaudimi i këtij objekti është i pjesshëm dhe jo përfundimtar, ndërkohë që AK ka kërkuar punë të ngjashme **të realizuara, të përfunduara**, pra të kolauduara totalisht në të gjitha aspektet ndërtimore e që të vërtetojë realizimin e objektit. Gjithashtu, ka pasaktësi edhe në plotësimin e formularit të vlerësimit, pasi referuar dokumenteve shoqëruese të këtij objekti, rezulton se investitor nuk është vetëm shoqëria “L.T.E CONSTRUCTION” shpk, por edhe shoqëria “ALTAN-SED” shpk, e cila duhet të ishte e cilësuar në rolin e investitorit në formularin e vlerësimit. Rrjedhimisht, kjo kontratë nuk merret në konsideratë për të provuar punën e ngjashme të kërkuar në DST. Gjithashtu, punët e tjera të paraqitura, të marra së bashku, në total nuk arrijnë dhe nuk plotësojnë vlerën e kërkuar në DST, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, duhet të jetë jo më e vogël se 300,000,000 (treqindmilion) Lekë pa TVSH.

Sa më sipër, nga OE “L.T.E CONSTRUCTION” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit dhe për këtë arsye skualifikohet.

**2. Operatori Ekonomik (OE) “KEVIN KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT K71401004W, me ofertë ekonomike në shumën prej **111,158,504.46** (njëqind e njëmbëdhjetëmilion e njëqind e pesëdhjetë e tetëmijë e pesëqind e katër pikë dyzetë e gjashtë) **lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të

mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk përmbush detyrimin për plotësimin korrekt të shtojcës 2 “Lista e Çmimeve sipas zërave të preventivit”, të DST, ku përcaktohet “*Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.*”. Nga kontrolli i preventivit të paraqitur nga “KEVIN KONSTRUKSION” shpk rezulton se nuk është pasqyruar njëri nga zërat e përcaktuar në preventivin e publikuar nga AK. Konkretisht, në preventiv, tek “Punime për mbrojtjen nga zjarri”, pika 3 “Fikëse zjarri me bombula”, nuk është pasqyruar (është fshirë) zëri 1, “v Fikëse zjarr pluhur karelato, destinacioni....” dhe për këtë arsye “KEVIN KONSTRUKSION” shpk skualifikohet.

**3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “B93 II” shpk, me NIPT L522090500 & “B93” shpk, me NIPT J62903508R, me ofertë ekonomike në shumën prej 111,403,301.53 (njëqind e njëmbëdhjetëmilion e katërqind e tremijë e treqind e një pikë pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk përmbush detyrimin për plotësimin dhe përmbushjen korrekte të pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me stafin mbështetës të kualifikuar, sipas ndarjes në përqindje (%) që anëtarët e bashkimit kanë marrë përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit. Konkretisht, anëtari me përqindje (%) më të madhe në bashkimin e operatorëve “B93” shpk (me 70%), ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, se ka staf mbështetës të kualifikuar gjithësej 7 (shtatë) punonjës, ndërkohë që referuar pjesëmarrjes në BOE, duhet të kishte dhe të deklaronte si staf mbështetës të paktën 15 punonjës, e parë kjo në raport me numrin total të punonjësve të kualifikuar, të kërkuar në pikën 2.3.7, të DST. Në nenin 88, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]*”.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga anëtari i BOE “B 93” shpk, në deklaratën e veçantë në plotësim të pikës 2.3.5, të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, ka paraqitur si drejtues teknik të punimeve në objekt z. D.L., i cili referuar deklarimit të vetë subjektit në formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, është me profesion **inxhinier hidroteknik**. Kjo gjë bie ndesh më përcaktimet e bëra në Udhëzimin e KM nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht me pikën 2.1, të këtij udhëzimi, ku përcaktohet: “2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për

vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe **i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.**”.

Për këto arsye BOE “B93 II” shpk & “B93” shpk skualifikohet.

**4. Operatori Ekonomik (OE) “AIDA KONSTRUKSION” shpk**, me NIPT M03116403L, me ofertë ekonomike në shumën prej **119,486,280.40** (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tetëdhjetë pikë dyzetë) **lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, sa i takon kontratave të ngjashme, në kuptim të nenit 77 të LPP dhe pikës 5, të nenit 39, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se disa prej kontratave të paraqitura nga “AIDA CONSTRUCTION” shpk kanë mangësi në dokumentacionin shoqërues të tyre dhe nuk përmbushin kushtin për t’u konsideruar si kontrata të ngjashme me kontratën objekt prokurimi. Konkretisht, nuk konsiderohen kontrata të ngjashme: - “Riparimi i nënkalimit SK Hamil Fier”, -“Ndërtim panele fotovoltaike për përdorim vetiak”, -“Ndërtim sere bujqësore për rritje fidanësh”, -“Riparim i digës Vlashuk”, - “Rehabilitimi i rezervuarëve dhe përrenjëve që ndodhen në territorin e bashkisë Divjakë”, -“Rikonstruksion i rrugës lidhëse Zharrëz – Shën Maria”, -“Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri – Sheqishte”. Kontratat e tjera që vlerësohen të ngjashme me objektin e prokurimit, kanë mangësi në dokumentacionin shoqërues të tyre dhe si të tilla nuk konsiderohen për të provuar realizimin e punës së ngjashme të kërkuar, si psh: - për kontratën e porosisë (nënkontraktim) me shoqërinë “Ed Konstruksion” shpk, me objekt “Punime rifiniture, elektrike, hidraulike...”, mungon akti i kolaudimit dhe kontrata bazë e kontraktorit me investitorin; -për kontratën me Ministrinë e Financës, me objekt “Rikonstruksion shkollë hoteleri turizëm Tiranë” mungon akti i kolaudimit; -për kontratën e lidhurm me Bashkinë Patos, me objekt “Rikonstruksion magazina Gani Banaj...” nuk janë paraqitur faturat tatimore. Sa më sipër, kontratat e ngjashme të paraqitura nga OE “AIDA CONSTRUCTION” shpk, nuk përmbushin asnjë prej kushteve të përcaktuara në shkronjat “a” ose “b” të pikës “2.3.1.”, sa i përket vlerës së kontratave të ngjashme të mëparshme, pasi kushti sipas shkronjës “a” kërkon punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 75,000,000 Lekë pa Tvsh, ndërsa kushti sipas shkronjës “b” kërkon “punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 300,000,000 Lekë pa Tvsh. Për këtë arsye “AIDA CONSTRUCTION” shpk shpk skualifikohet.

**5. Operatori Ekonomik (OE) “PEPA GROUP” shpk**, me NIPT L42215009L, me ofertë ekonomike në shumën prej **120,188,262.54** (njëqind e njëzetë milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe**

**nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.4. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me stafin inxhinierik të kërkuar (drejtues teknik), pasi në formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, nuk ka deklaruar se ka të punësuar 1 inxhinier mekanik në pozicionin drejtues teknik në licencën e shoqërisë. Për këtë arsye “PEPA GROUP” shpk skualifikohet.

**6. Operatori Ekonomik (OE) “BEAN” shpk**, me NIPT J72510445Q, me ofertë ekonomike në shumën prej **121,397,938** (njëqind e njëzetë e njëmilion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) **lekë pa TVSH**, **nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.7. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me stafin mbështetës të kërkuar dhe konkretisht: Në pikën 2.3.7 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim, të DST, autoriteti kontraktor ka kërkuar “*Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf mbështetës të kualifikuar, i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, minimalisht: 2 (dy) teknik ndërtimi; 3 (tre) muratorë/suvatues; 2 (dy) hekurkthyes; 3 (tre) karpentier; 2 (dy) pllakashtrues; 2 (dy) bojaxhinj; 2 (dy) elektrikist; 2 (dy) hidraulik; 2 (dy) manovratorë; 2 (dy) shofer;*”, pra gjithësej **22 (njëzet e dy)** punonjës si staf mbështetës të kualifikuar. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga OE ofertues “BEAN” shpk (*Formularit të Vetëdeklarimit të “BEAN” shpk*), për plotësimin e kësaj kërkesë, ky i fundit ka deklaruar se disponon dhe ka deklaruar **7 (shtatë)** punonjës si staf mbështetës të kualifikuar, ndërsa për pjesën tjetër të stafit mbështetës të kualifikuar, është mbështetur në kapacitetet e fuqisë punëtore të kualifikuar të subjektit mbështetës “SARDO” shpk.

Bazuar në paragrafin e fundit, të pikës 2, të nenit 90, të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, ku përcaktohe se: “*Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.*”, referuar dokumentacionit të paraqitur në SPE nga OE ofertues “BEAN” shpk, si dhe duke qënë se OE ofertues “BEAN” shpk ka deklaruar **7 (shtatë)** punonjës si staf mbështetës të kualifikuar, ndërkohë që bazuar në dispozitën ligjore të sipërcituar duhet të provonte se plotëson vetë të paktën 50% të kërkesës për staf mbështetës të kualifikuar (*pra, të paktën 11 punonjës të kualifikuar*), rezulton se OE ofertues “BEAN” shpk nuk ka zbatuar dispozitën ligjore të sipërcituar, dhe si pasojë nuk plotëson kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.7 të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim, të DST, dhe për këtë arsye skualifikohet.

**7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “COGREN” shpk**, me NIPT J74818825K & “**JOGI**” shpk, me NIPT J63229478K & “**A.E.K & CO**” shpk, me NIPT K64331804P, me ofertë ekonomike në shumën prej **122,222,222** (njëqind e njëzetë e dymilion e dyqind e

njëzetë e dymijë e dyqind e njëzetë e dy) **lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 1/a, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me deklaratimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8), pasi anëtari i bashkimit “JOGI” shpk, në rubrikën “B: Deklarata”, ka selektuar/çekuar alternativën a. “Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;”, ndërkohë që në rastin e BOE duhet selektuar/çekuar alternativa “b” (*shiko edhe Vendimin e KPP-së, nr.1338/2023, faqe 30*).
- Nuk plotëson pikën 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, pasi nga anëtari lider i bashkimit të operatorëve ekonomikë, “COGREN” shpk nuk përmbushet detyrimi për plotësimin e kësaj pike. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se kontratat e paraqitura kanë mangësi në dokumentacionin shoqërues të tyre dhe nuk përmbushin kushtin për t’u konsideruar si kontrata të ngjashme me kontratën objekt prokurimi, pasi janë të natyrës ujësjellës-kanalizime. Rrjedhimisht, për sa kohë që kërkesa sipas pikës 2.3.1, nuk përmbushet nga anëtari me përqindjen (%) më të madhe në bashkim, kjo kërkesë konsiderohet e papërmbushur nga i gjithë bashkimi i OE. Gjithashtu, nga anëtari i bashkimit “A.E.K & CO” shpk, nuk është paraqitur asnjë punë e ngjashme e realizuar, në raport me përqindjen (%) e marrë përsipër në bashkëpunim, gjë e cila bie ndesh me përcaktimet e nenit 88, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. [...]”*
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga anëtari i BOE, “COGREN” shpk, në deklaratën e veçantë në plotësim të pikës 2.3.5, të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, ka paraqitur si drejtues teknik të punimeve në objekt z. G.M., i cili referuar deklarimit të vetë subjektit në formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, është me profesion **inxhinier hidroteknik**. Kjo gjë bie ndesh me përcaktimet e bëra në Udhëzimin e KM nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht me pikën 2.1, të këtij udhëzimi, ku përcaktohet: “2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe **i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.**”
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.2.2. të Kapacitetit ekonomik dhe financiar, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të



Tenderit, pasi për anëtarin e bashkimit “JOGI” shpk, nuk janë paraqitur bilancet vjetore për tre vitet e fundit financiare 2021, 2022, 2023.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.2. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi për anëtarin e bashkimit “JOGI” shpk, nuk është paraqitur liçenca profesionale e shoqërisë.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga anëtari i BOE, “JOGI” shpk, në deklaratën e veçantë në plotësim të pikës 2.3.5, të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, ka paraqitur si drejtues teknik të punimeve në objekt z. J.B., i cili referuar deklaramit të vetë subjektit në formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, është me profesion **inxhinier gjeolog**. Kjo gjë bie ndesh me përcaktimet e bëra në Udhëzimin e KM nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht me pikën 2.1, të këtij udhëzimi, ku përcaktohet: “2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe **i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.**”.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.9. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi për anëtarin e bashkimit “JOGI” shpk, nuk janë paraqitur certifikatat ISO të kërkuara. Për arsyet e mësipërme BOE “COGREN” shpk & “JOGI” shpk & “A.E.K & CO” shpk skualifikohet.

**8. Operatori Ekonomik (OE) “DAJTI PARK 2007” shpk**, me NIPT K11507003S, me ofertë ekonomike në shumën prej **139,022,318.42** (njëqind e tridhjetë e nëntëmilion e njëzetë e dymijë e treqind e tetëmbëdhjetë pikë dyzetë e dy) **lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, sa i takon kontratave të ngjashme, në kuptim të nenit 77 të LPP dhe pikës 5, të nenit 39, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Konstatohet se për këtë procedurë prokurimi “DAJTI PARK 2007” shpk, ka paraqitur në SPE gjithësej 9 (nëntë) kontrata (përvoja) të mëparshme, nga të cilat 6 (gjashtë) kontrata kanë si objekt “ndërtim rrugësh” dhe “zgjerrim i hapësirave të varrezave publike”, të cilat nuk vlerësohen punë të ngjashme me objektin e prokurimit. Gjithashtu, ka paraqitur në SPE 1 (një) përvojë të mëparshme të ngjashme me objekt “Ndërtim i objektit multifunksional (social ekonomik dhe banim) 9 dhe 11 kate, sipas Lejes së ndërtimit nga Bashkia Tiranë Nr.A-...datë .....2020”, por për këtë kontratë OE ofertues nuk ka paraqitur **Formularin e Vlerësimit sipas Shtojcës 9**, si dhe nuk ka paraqitur **Aktin e Kolaudimit përfundimtar** të objektit për realizimin e plotë të investimit sipas Lejes së ndërtimit (akti i kolaudimit të këtij objekti, i paraqitur në SPE, është i pjesshëm dhe jo përfundimtar, ndërkohë që AK ka kërkuar punë të ngjashme të

**realizuara, të përfunduara**, pra të kolauduara totalisht në të gjitha aspektet ndërtimore e që të vërtetojë realizimin e objektit.), gjë që vjen në kundërshtim me kërkesat për kualifikim të përcaktura në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik në DST, si dhe vjen në kundërshtim me përcaktimet e pikës 5, të nenit 39, të VKM nr.285, datë 19.5.2021, ku përcaktohet se “Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”. Për 2 (dy) kontratat e ngjashme të mbetura të cilat në aspektin e objektit janë të ngjashme me objektin e prokurimit, vlerat e tyre takuese të O.E. “DAJTI PARK 2007” shpk, as tek e tek dhe as së bashku nuk plotësojnë vlerën e kërkuar për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik në DST. Për këtë arsye O.E. “DAJTI PARK 2007” shpk skualifikohet.

**9. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk**, me NIPT K82230002K & “STERKAJ” shpk, me NIPT J68310708M, me ofertë ekonomike në shumën prej **144,259,631** (njëqind e dyzetë e katërmilion e dyqind e pesëdhjetë e nëntëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e një) **lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 1/a, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me deklaratimet e bëra në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8), pasi të dy anëtarët e bashkimit si “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk ashtu edhe “STERKAJ” shpk, në rubrikën “B: Deklarata”, kanë selektuar/çekuar alternativën a. “Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;”, ndërkohë që në rastin e BOE duhet selektuar/çekuar alternativa “b”.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8), janë përcaktuar qartësisht rubrikat që duhet të plotësohen apo të vetëdeklarohen saktësisht nga subjektet ofertuese, rubrika në të cilat duhet të përcillet dhe të jepet informacion i saktë për autoritetin kontraktor, mbi bazën e të cilit bëhet edhe kualifikimi ose jo në fazën paraprake të vlerësimit. Mosplotësimi korrekt i tyre konsiderohet si informacion i pasaktë dhe për këtë arsye BOE “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk & “STERKAJ” shpk skualifikohet (shiko edhe Vendimin e KPP-së, nr.1338/2023, faqe 30).

**10. Operatori Ekonomik (OE) “DESARET COMPANY” shpk**, me NIPT K01816001J, me ofertë ekonomike në shumën prej **149,770,495.07** (njëqind e dyzetë e nëntëmilion e shtatëqind e shtatëdhjetëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e pesë pikë zero shtatë) **lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta për Kualifikim, të Shtojcës 7, të Dokumentave Standarte të Tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme. Për të provuar punën e ngjashme të mëparshme “DESARET COMPANY” shpk ka paraqitur kontratën me objekt “Rindërtim i shkollës 9-vjeçare në Bërxullë...”, të lidhur me UNDP. Nga shqyrtimi i dokumentacionit shoqëruar të ngarkuar në SPE, rezulton se për këtë kontratë nuk është paraqitur Formulari i Vlerësimit sipas modelit të shtojcës 9, pjesë e setit të DST të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Për këtë arsye “DESARET COMPANY” shpk skualifikohet.

**11. Operatori Ekonomik (OE) “EB-2000” shpk**, me NIPT L87708801M, me ofertë ekonomike në shumën prej **159,100,000** (njëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e njëqind mijë) **lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi nuk ka paraqitur detajimin e ofertës sipas shtojcës 2 (nuk ka paraqitur preventiv punimesh), si dhe nuk ka paraqitur asnjë prej dokumentave të kërkuara në DST për plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta dhe rrjedhimisht skualifikohet.

**12. Operatori Ekonomik (OE) “SENKA” shpk**, me NIPT J94808405Q, me ofertë ekonomike në shumën prej (oferta pas korrigjimit) **160,326,597.43** (njëqind e gjashtëdhjetë milion e treqind e njëzetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë dyzetë e tre) **lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit **dhe nuk kalon në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave**, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi:

- Në vijim të procedurës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, në përputhje me kërkesat e pikës 2, të nenit 92, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe në përcaktimet e pikës 3, të nenit 82, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, gjatë kontrollit të ofertës ekonomike të paraqitur nga “SENKA” shpk (kontrollit aritmetik të preventivit), është konstatuar se oferta ka gabim aritmetik, i cili tejkalon vlerën e fondit limit të procedurës objekt prokurimi dhe për këtë arsye ky operator do të skualifikohet. Në arritjen e këtij përfundimi, KVO referohet në gërmën “a”, të pikës 3, të nenit 82, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij”.*

Konkretisht, në preventiv-ofertën e paraqitur nga “SENKA” shpk, në seksionin VII “Punime ashensori”, rezulton gabimi i pasqyruar si më poshtë:

1	An-2	F.v Ashensor mekanik	cope	1	4,000,000	<b>3,500,000</b>
---	------	----------------------	------	---	-----------	------------------

Ndërkohë që referuar kalkulimit korrekt të veprimit aritmetik, duhet të ishte:

1	An-2	F.v Ashensor mekanik	cope	1	4,000,000	<b>4,000,000</b>
---	------	----------------------	------	---	-----------	------------------

Oferta e korrigjuar, reflekton në shumën përfundimtare prej **160,326,597.43 Lekë pa TVSH** (pas korrigjimit), shumë e cila e tejkalon fondin limit të procedurës objekt prokurimi, i cili është **159,811,598 Lekë pa TVSH**.

Duke u nisur nga përcaktimi i bërë në dispozitën e mësipërme, u bë korrigjimi i çmimit total, i cili rezulton të jetë mbi fondin limit të procedurës objekt prokurimi dhe rrjedhimisht “SENKA” shpk skualifikohet.

**\* \* \***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “**RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN**” ShA, me numër NIPT J629042640, me adresë qendrore sipas QKB: Elbasan Bradashesh BALEZ POSHTE Fshati Balez Poshte, zona kadastrale nr.1079, nr.pasurise 322/11, 1 km nga kryqezimi i fshatit Kusarth (ne kryqezimin e rruges se fabrikes se çimentos rrugen e fshatit Balez Siper), se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **105,635,461.40** (njëqind e pesëmilion e gjashtëqind e tridhjetë e pesëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një pikë dyzetë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër, me adresë lagjja “18 Prilli”, Ballsh, Mallakastër, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës tuaj dhe do të veprohet siç parashikohet në nenin 83, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anulimit të Procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

(me urdhër për delegim kompetence)

**Guri Nuhaj**